

**RREGULLORE E VEÇANTË MBI KRIJIMIN E NJË SISTEMI TË SAKTË, TË
BESUESHËM E TË MBROJTUR NGA ABUZIMET PËR LËSHIMIN, PROCEDURAT E
TRANSFERIMIN DHE REVOKIMIN E GARANCIVE TË ORIGINËS**

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

AUTORITETI

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 16 pika 13, të Ligjit nr.7/2017 “*P r nxitjen e p rdorimit t energjis nga burimet e rinovueshme*””, si dhe në përputhje me “*Rregulloren e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s*”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016.

Neni 2

QËLLIMI

Në funksion të zhvillimit dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve energjitike të rinovueshme, qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent, për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilët paraqesin në ERE aplikimin për Garancinë e Origjinës osë që janë subjekt i transferimit apo revokimit të saj.

Neni 3

OBJEKTI

Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen e Garancisë së Origjinës (GO), dokumentacionin teknik që do të paraqitet nga aplikuesi dhe procedurën e kualifikimit teknik. Kjo rregullore, parashikon udhëzime teknike dhe proceduriale për lëshimin nga ERE të GO e cila do të vërtetojë se një pjesë apo tërësisht energjia e prodhuar nga aplikuesi është gjeneruar nga shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike.

Neni 4

ZBATIMI

Kjo rregullore do të zbatohet për lëshimin e garancisë së origjinës nga ERE për prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme siç është përcaktuar në ligjin Nr 7/2017 “*P r nxitjen e p rdorimit t energjis nga burimet e rinovueshme.*”

Neni 5

PËRKUFIZIME

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj” do të thotë Ligji nr.7/2017 “*P r nxitjen e p rdorimit t energjis nga burimet e rinovueshme.*” “Bordi ” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të

emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ,

2. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike” dhe 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror.”
3. “I liçensuar” do të thotë një person që mban një licensë të dhënë sipas Pjesës së Katërt të Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
4. “Garancia e Origjines (GO)”, është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t’i provoj konsumatorit p rfundimtar se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë së përdorur është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.
“Energjia nga burimet e rinovueshme” është energjia nga burime të rinovueshme jofosile, konkretisht era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gaz i grumbulluar në landfille, gaz, që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet.
5. “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga veprimtaria bujqësore (përfshirë lëndë bimore dhe shtazore), pyjore dhe nga industri të lidhura me to, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si edhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale, urbane dhe rurale. .
6. “Energji gjeotermike” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë në sipërfaqen e tokës.
7. “Biogazi” do të thotë përzierja e gazit metan me dioksid karboni, e prodhuar nga dekompozimi bakterial i mbetjeve organike dhe që përdoret si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike.
8. “Subjekt i licencimit” do të thotë Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, struktura e ERE-s e ngarkuar për shqyrtimin e një kërkesë për kualifikim apo lëshimin e GO.
9. “Kërkues” do të thotë prodhues i energjisë elektrike që kërkon të pajiset me garancinë e origjinës pas marrjes së të drejtës për ndërtimin e impiantit të energjisë së rinovueshme.
10. “Central prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme”, është një impiant që prodhon energji nga burime të rinovueshme.
11. “Prodhues hibrid” është centrali elektrik i cili konsumon të dy llojet e burimeve të energjisë, të rinovueshme dhe jo të rinovueshme.
12. “Rezervë pompimi” do të thotë një sistem hidroelektrik në të cilin energjia elektrike prodhohet gjatë periudhave të pikut të kërkesës nga përdorimi i ujit që është pompuar në një rezervuar në një lartësi më të madhe, gjatë periudhave jo të pikut, me kërkesë më të ulët për energji elektrike.

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR GO

Neni 6

KLASIFIKIMI I CENTRALEVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE

Tipet e teknologjive prodhuese të cilat mund të përfitojnë GO , janë përshkruar në tabelën 1.1

Tabela 1.1. Klasifikimi i prodhuesve të energjisë, të cilët gjenerojnë energji nga burime të rinovueshme.

Tipi i impiantit		Nentipi i impiantit	Burimi
Hidro		Rrjedhe lumi Rezervuar Bazen Kanal derivacioni	Ujë
Era (Eolike)		Të vendosur në det (onshore), në toke (offshore)	Era
Gjeotermale		-	Energjia gjeotermike
Djellore (Solare)		Fotovoltaike Fotovoltaike / termike	Energji djellore
Termale		Avulli Djegja e brendshme Cikël i kombinuar	Biomasë***
		Gazi Të tjera	Biogaz
Hibrid*	Bashkë – djegje**	-	Burime konvencionale
	Të tjera	-	Burime të rinovueshme

* Impiantet hibride gjenerojnë energji elektrike nga përdorimi i të dyja burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme dhe përfshijnë impiantet me bashkë-djegje

** Bashkë-djegja perkufizohet si djegja njëkohësisht e lëndëve djegëse dhe trupave të ngurtë jo të rinovueshëm dhe lëndëve të lëngëta ose gazore të përftuara nga burime të rinovueshme.

Nëntipi i impiantit është i njëjtë me atë të impianteve termike.

*** Biomasa dmth pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndet bimore, shtazore) pylltaria dhe industrite e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.

KERKESAT PËR DHËNIEN E GO IMPIANTEVE PRODHUESE

7.1 Prodhuesi i cili dëshiron të marrë garancinë e origjinës së impiantit prodhues, paraqet në ERE një kërkesë specifike me shkrim, duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar nga ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe atë të kërkuar nga kjo rregullore. Aplikuesi duhet të parqesë dokumenta të përshtashme të certifikuara nga autoritetet publike kompetente.

7.2 Garancia e Origjinës për një impianti prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet vetëm një herë në 12 muaj, me përjashtim të rasteve kur janë kryer ndryshime të mëdha në impiantet prodhuese të energjisë elektrike të cilat janë të pajisura me parë më GO.

7.3 Kërkesa për GO mund të paraqitet gjithashtu për një central prodhues energjie të rinovueshme dhe në fazën e projektimit ose në fazën e ndërtimit pas marrjes së të drejtës për ndërtimin e impiantit të energjisë së rinovueshme.

7.4 Kërkesa për lëshimin e GO përfshin:

- a) burimin e energjisë, nga i cili prodhohet energjia;
- b) datën e fillimit të përfundimit të prodhimit;
- c) emrin, vendin, tipin dhe kapacitetin e impiantit ku shtet prodhuar energjia;
- ç) nëse prodhuesi ka përfutur prej mbështetjes me investime ose nga skemat tjera të mbështetjes në nivel kombëtar dhe masat e kësaj përfuturi;
- d) datën e autorizimit të impiantit dhe kohën kur shtet futur në punë;
- e) një raport teknik specifik që përshkruan tipin e teknologjisë gjeneruese siç përcaktohet në tabelën (1.1.) e sipërpërmendur në nenin 6.
- ë) një dokument teknik i cili përshkruan karakteristikat bazë të prodhuesit të energjisë, përfshirë anekset teknike nëse ka.
- f) cdo dokument tjetër të lëshuar që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë.

7.5 Dokumentacioni teknik përmban:

1. përshkrimin e përgjithshëm të centralit

- a. burimet e energjisë (të rinovueshme ose jo)
- b. tipi i centralit.
- c. kapaciteti nominal që jepet nga shuma e kapacitetit nominal të turbinave ose agregateve, siç raportohet në targetat e secilit element.
- d. prodhimin e pritshëm vjetor

2. Dokumentat vijues grafik

- a. Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1 planimetria e përgjithshme e centralit
- b. skema funksionale
- c. skema elektrike me qëllim identifikimin e matësave të gjenerimit të energjisë elektrike të certifikuar nga autoriteti publik kompetent.

3. Përshkrimi i centralit duhet të jetë edhe më i detajuar për:

- a. Hidrocentralet që përdorin dhe rezerva pompimi, në mënyrë që të llogariten sasitë e energjisë që i përkasin kësaj rezerve pompimi, mbasi kjo sasi energjie përjashtohet nga prodhimi që mund të përfitojë GO.
- b. Centrale që djegin mbetje me qëllim llogaritjen e pjesës së energjisë elektrike të prodhuar, që i takon pjesës së biodegradueshme të mbetjeve, pasi vetëm kjo mund të përfitojë GO.

Neni 8

FILLIMI I PROCEDURAVE TE LËSHIMIT TË GO

ERE, në përputhje me "Rregullat e organizimit, funksionimit dhe Procedurave të saj, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016. kur e gjykon të arsyeshme merr vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me GO, dhe cakton për çdo kërkesë subjektin relatues të çështjes, i cili është edhe pika e kontaktit e ERE me kërkuesin. ERE mund të kërkojë çdo sqarim si dhe të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për palët në proces.

Neni 9

SHQYRTIMI I APLIKIMIT PËR LËSHIMIN E GO

- 9.1 Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës së shqyrtimit, sipas nenit 8 të kësaj rregullore, brenda 60 ditëve ERE shqyrton aplikimin dhe informon kërkuesin për vendimin e Bordit mbi lëshimin GO ose refuzimin e kërkesës së tij. ERE vendos për lëshimin e GO të prodhuesit të energjisë së rinovueshme:
 - 1) që furnizohet nga një central i prodhimit të energjisë direkt në rrjetin publik të shpërndarjes ose
 - 2) përdoret për konsum të vetë prodhuesit të energjisë elektrike.
- 9.2 Lëshimi i GO do të konsiderohet i kryer automatikisht nga ERE në rast se kërkuesit nuk do t'i jepet asnjë komunikim brenda 60 ditëve të sipërpërmendura.
- 9.3 Brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Bordi merr vendim për :
 - a. Lëshimin e GO së kërkuar, i cili regjistrohet në regjistrin elektronik të garancive të origjinës që mbahet nga ERE
 - b. Revokimi i lëshimit të GO në rast se subjekti nuk përmbush kërkesat e nevojshme, procedurën apo dokumentacionin e kërkaur sipas nenit 16 pika 13 gërma "b";
 - c. Pëzullimin e procesit të shqyrtimit të kërkesës.
- 9.4 Në çdo rast të vendimit për revokim të GO, ERE arsyeton vendimin për revokimin. Kur ERE konstaton se kërkesa për pajisje me GO e paraqitur nga aplikuesi, nuk përmban

dokumenta të rëndësishme që pengojnë ERE-n në verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregullore, ERE specifikon që dokumentacioni është jo i plotë.

9.5 ERE mund të revokojë njohjen e garancisë së origjinës vetëm kur ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e saj. ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për çdo revokim të bashkuar me arsyet për të. Mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë merret parasysh nga ERE në lëshimin e garancive të origjinës.

9.6 ERE merr vendim për pezullim të procesit të shqyrtimit të kërkesës, kur kërkesa nuk përmban disa dokumente të cilat pengojnë ERE-n në verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregullore. ERE i komunikon kërkuarës brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, që shqyrtimi i kërkesës është pezulluar. ERE specifikon dokumentat që mungojnë ose janë jo të plotë, të cilat duhet t'i paraqiten ERE-s brenda 60 ditëve në vijim. Në vijim të analizës së dokumentacionit shtesë, kërkesa mund të pranohet ose revokohet. Nëse dokumentacioni i munguar apo shtesë nuk dërgohet brenda 60 ditëve nga data e njoftimit nga ERE, kërkesa revokohet për shkak të mosplotësisë së dokumentacionit të nevojshëm.

9.7 ERE kur e sheh të arsyeshme mund të kërkojë verifikimin e çdo informacioni të nevojshëm nga organet kompetente, duke vënë në dijeni kërkuarësin për këtë.

9.8 Në çdo rast të marrjes së vendimit nga Bordi për revokimin e kërkesës për pajisje me GO, aplikuesi mund të paraqesë një kërkesë të re duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

Neni 10

LËSHIMI I GARANCIVE TË ORIGJINËS (GO)

10.1 Prodhuesi mund të paraqesë kërkesë për pajisjen me GO për sasinë e energjisë elektrike realisht të prodhuar, në bazë vjetore, nga centralet prodhuese të energjisë, siç përshkruhet në nenet 7, 8 dhe 9 dhe pas vënies në punë të impiantit prodhues.

Data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë e lidhur me rrjetin elektrik duhet të jetë pas datës së lidhjes së kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike.

10.2 Garancia e Origjinës lëshohet për :

- a) një njësi të energjisë elektrike 1 MWh
- b) Sasinë e prodhuar në vit, të energjisë elektrike, nga hidrocentralet përveç sasisë që i atribuohet rezervave të pompimit të gjithë prodhimit vjetor të energjisë elektrike nga hidro (ujore), eolike (era), solare (diellore), gjeotermike, , batica dhe zatica, biomasa dhe biogazi.
- c) Sasinë e prodhuar të energjisë elektrike që i takon pjesës së biodegradueshme të mbetjeve urbane dhe industriale, të cilat digjen brenda centraleve termike.

10.3 ERE sipas kërkesave do të lëshojë çdo vit GO për energjinë elektrike realisht të prodhuar nga impiantet dhe vetëm në rastet se/ kur impianti është në punë. Çdo GO i korrespondon 1 MWh energji elektrike të hedhur në rrjet (në muaj) në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10.4 Cdo GO e lëshuar nga ERE rregjistrohet në regjistrin elektronik të garancive të origjinës që mbahet nga ERE të pershkruar në Ankesin A të kësaj rregullore. Çdo përdorim i një garancie origjine behet brenda 12 muajve nga data e prodhimit të njësisë korresponduese të energjisë elektrike. Garancia e origjinës anulohet menjëherë pasi është përdorur.

Neni 11

NDRYSHIME NE DETAJET TEKNIKE TE REGJISTRUARA

11.1 Prodhuesi duhet të informojë ERE për cdo modifikim të ndodhur në centralet prodhuese të energjisë së në përputhje me këtë rregullore.

11.2 Në rastet e centraleve në ndërtim, qëllimi i komunikimit të sipërpërmendur është të monitorojë realizimin e impiantit dhe të krahasojë karakteristikat finale teknike të tij me ato të komunikuar fillimisht së bashku me kërkesën për pajisje me GO.

11.3 Për impiantet prodhuese ende në fazë projekti, menjëherë pas vënies në punë të impiantit, prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s :

- a. çdo modifikim të mundshëm të detajeve teknike lidhur me projektin (psh ndryshime të fuqisë së instaluar, lloji i mbetjeve të përdorura etj.) fillimin e punës në rast të një ndërtimi të ri dhe datën e kolaudimit ;
- b. datën e fillimit të operimit për llogaritjen e periudhës së marrjes së GO.

11.4 Në veçanti komunikimi në lidhje me datën e operimit të impiantit prodhues për herë të parë, të lidhur me rrjetin elektrik duhet të certifikohet nëpërmjet aktit të kolaudimit të mbajtur në bazë të ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, sipas praktikave dhe rregullave të lidhjes në Sistemin Elektroenergjitik dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

11.5 Në rast se modifikimi i pershkruar, apo modifikimi për të cilin vihet në dijeni ERE, e bën projektin jo të përputhshëm me legjislacionin, GO e lëshuar me vendim të Bordit do të anulohet.

Në çdo kohë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të depozituara, ERE ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë, apo dhe të monitorojë në vend impiantit prodhues.

Neni 12

KOMUNIKIM PLOTËSUES PËR LËSHIMIN E GO TË IMPIANTEVE PRODHUESE TERMIKE

- 12.1 Në rastet kur prodhuesi kërkon pajisjen me GO për impiante termike prodhuese (jo hibrid) të ushqyer nga biomasa dhe biogazi, duhet të konfirmojë llojin e lëndës djegëse të përdorur.
- 12.2 Çdo modifikim i ndodhur duhet të komunikohet menjëhehere tek ERE nga prodhuesi. ERE do të procedojë në përputhje me legjislacionin në fuqi për verifikimin e të gjitha kërkesave të nevojshme për të vijuar me lëshimin e GO për impiantet prodhuese.
- 12.3 Nëse nuk jepet informacioni i kërkuar ose jepet informacion jo i vërtetë, e drejta për tu pajisur me GO humbet për të gjithë energjinë e prodhuar dhe për të gjithë periudhën kohore të mbetur.
- 12.4 Prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s çdo vit, një vlerësim teknik të prodhimit neto të energjisë elektrike nga lëndët djegëse konvencionale të përdorura.

NENI 13
NENI 13
TRANSFERIMI I GO

Garancia e origjinës mund të transferohet, veçmas ose së bashku me transferimin fizik të energjisë, dhe nuk do të ketë efekt në vendimin për të përdorur mekanizmin e bashkëpunimit për arritjen e objektivit apo në llogaritjen e konsumit final bruto të energjisë nga burime të rinovueshme, në përputhje me nenin 4 të ligjit.

Neni 14
AFATET KOHORE KUFITË APLIKUESHME

- 13.1 Në rastin e impianteve prodhuese që kanë GO dhe ende nuk janë në operim, GO do të anulohet me inisiativën e ERE, nëse prodhuesi nuk i komunikon ERE-s:
 - a. Fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda 18 muajve nga data e lëshimit të GO;
 - b. Fillimin e punës paralelisht me rrjetin elektrik, brenda 3 vjetëve nga data e lëshimit të GO;
- 13.2 Në të dy rastet, prodhuesi mund të paraqesë një kërkesë të re për tu kualifikuar sipas procedurave të kësaj rregullore.

Neni 15
LLOGARITJA E ENERGJISË

14.1 Paragrafët në vijim përshkruajnë llogaritjen e energjisë neto E_{cv} që përfiton GO. Energjia e llogaritur nga prodhuesit duhet të jetë në përputhje me tipin e prodhuesit të energjisë dhe të dhënat teknike të përshtatshme. ERE ka të drejtë të verifikojë dhe t'i paraqesë prodhuesit një vlerësim të ndryshëm të energjisë.

Prodhimi neto i një prodhuesi energjie, është prodhimi bruto duke zbritur energjinë e marrë për nevojat vetjake dhe humbjet në transformatorët në gjenerim.

E gjithë energjia neto e prodhuar nga një prodhues i ri energjie i ushqyer plotësisht nga burime energjie të rinovueshme përfiton nga GO.

Neni 16

INSPEKTIMET TEKNIKE

Për të siguruar përmbushjen e kushteve të lëshimit të garancis origjinale dhe të dhënave, mbi të cilat është lëshuar ajo, janë të sakta, përfaqësuesit e ERE-s dhe çdo person i autorizuar prej saj, pa paragjykim lidhur me respektimin e sekretit tregtar, kanë akses të lirë në impiantin përkatës të prodhimit dhe në të gjitha të dhënat dhe informacionin për atë impiant të dhënë.

Prodhuesi është i detyruar të lehtësojë punën e përfaqësuesve të ERE-s dhe të personave të autorizuar prej tij. Në rastet e deklarimit jo të vërtetë kualifikimi anulohet dhe çdo e drejtë e lidhur me këtë humbet. ERE rezervon të drejtën e marrjes së masave administrative, në rastet e konstatimit të përsëritur të deklarimit të të dhënave të rreme.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

BASHKË PUNIMIN ME AUTORITETET KOMPETENTE

GO e dhënë në Shqipëri do të njihet edhe nga autoritetet kompetente të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera, me të cilat vendi ynë ka marrëveshjet nënshkruara për njohjen e ndërsjellë të garancive të origjinale.

Neni 18

AMENDIME TË RREGULLORES

1. Kjo rregullore është objekt i rishikimit dhe ndryshimit me vendim të Bordit, në përputhje me Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.

Neni 19

HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore u miratua me vendimin e Bordit të ERE nr. __, datë __.__.2017 dhe hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.